


Si mund të ankojem në rastin e shkeljes së privatësisë nga përdorimi i sistemit të video survejimit?

E drejta e ankimit është e garantuar për çdo individ, i cili ndjehet i cenuar nga prania e kamerave, në përputhje me nenin 16 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Paraprakisht, ankesa i duhet drejtuar kontrolluesit (institucioni publik apo subjekti tregtar privat) që ka në përdorim sistemin CCTV. Në rast mosreagimi ankesa i drejtohet Zyrës së Komisionerit. Ankuesi ka detyrimin që përveç plotësimin të formës së ankesës, të paraqesë edhe prova (foto, shkresa, etj.) që kanë lidhje me pretendimin për cenim të privatësisë. Në rast se Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të rastit të paraqitur në ankesë, vlerëson se ekziston mundësia e cenimit të privatësisë, fillon hetimin administrativ ndaj kontrolluesit.

Ndërsa, në rastet kur kamerat dhe arkiva/baza e të dhënave të siguruar nga përdorimi i sistemit CCTV ndodhen në një banesë private, individi (subjekti i të dhënave) mund t'i drejtohet strukturave të Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë në përputhje me nenin 121 të Kodit Penal “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”.



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Rr. Abdi Toptani, Nd. 5, Tiranë

www.idp.al

info@idp.al

+355 42237200

0800 2050

VIDEO SURVEJIMI – SISTEMI CCTV – TË DREJTAT TUAJA

Zhvillimi dinamik i teknologjisë përgjatë dekadave të fundit, ka ndryshuar rrënjësisht ndjeshmërinë dhe perceptimin ndaj privatësisë. Veçanërisht, përdorimi masiv i sistemeve të video survejimit në shumë sfera të jetës shoqërore, qoftë nga institucionet publike, ashtu edhe nga subjektet private, ka nxitur nevojën për forcuar mënyrat për mbrojtjen e të dhënave personale.



Si realizohet video survejimi?

Kjo realizohet nëpërmjet instalimit dhe përdorimit të sistemit për video survejim me kamera. Ky sistem në gjuhën teknike quhet CCTV/Closed-circuit television – television me qark të mbyllur.

Këto pajisje vendosen në godina dhe ambiente të ndryshme dhe mundësojnë krijimin e një arkivi/baze të dhënash. Përgjithësisht, instalimi i një sistemi të tillë ka si qëllim forcimin e masave të sigurisë, ruajtjen e rendit publik dhe parandalimin e ngjarjeve me natyrë kriminale.

A përcakton ligji kufizime në përdorimin e sistemit të video survejimit?

Të drejtën për instalimin e sistemeve të tilla e ka çdo institucion publik ose subjekt tregtar privat. Ata janë të detyruar, që përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale, të njoftojë me shkrim

Zyrën e Komisionerit sipas përcaktimeve të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, dt. 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Gjithashtu, në përputhje me këtë ligj duhet të përmbushin të gjitha detyrimet e tjera që parashikohet në të.




Cilat janë rregullat për ushtrimin e një veprimtarie në këtë drejtim?

Rregullat e përgjithshme për grumbullimin, përpunimin, përdorimin, ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave personale janë të përcaktuara në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Ndërsa, rregullat specifike për qëllimin, mënyrën dhe masat e sigurisë janë të përcaktuara në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit, datë 05.03.2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar. Gjithashtu, "Udhëzuesi për përdorimin e sistemit CCTV" është një udhërrëfyes i rëndësishëm për përdorimin në praktikë të sistemit të video survejimit.

A duhet të vihem në dijeni për survejimin e një mjedisi të caktuar nga sistemi CCTV?

Kontrolluesi - sipas përcaktimit ligjor, (institucion publik apo subjekt tregtar privat) që ka instaluar dhe përdor një sistem të tillë ka detyrimin sipas Udhëzimit nr.3, të informojë nëpërmjet vendosjes së tabelës së posaçme në vende të dukshme, të gjithë personat që e frekuentojë objektin/ambientin ku është vendosur sistemi i video survejimit.



A kam të drejtën të kundërshtoj përdorimin e sistemit CCTV kur shkelet e drejta ime e privatësisë?

Nëse vlerësoni se shkelet privatësia juaj nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV keni të drejtë të kundërshtoni këtë lloj përpunimi në bazë të nenit 15 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Ju duhet t'i drejtoheni kontrolluesit (institucion publik apo subjekt tregtar privat) që e ka instaluar sistemin, i cili duhet të përmbushë detyrimet sipas ligjit në fjalë.



A kam të drejtë të kem akses në bazën e të dhënave të sistemit të video survejimit që kanë regjistruar të dhënat e mia?

E drejta e aksesit garantohet për çdo subjekt të të dhënave (individ) në përputhje me neni 12 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe kufizohet vetëm për të dhënat që i përkasin subjektit që ka bërë kërkues për akses. Kjo do të thotë, që në asnjë rast nuk mund të aksesohen të dhënat personale të

Po në rastet kur sistemi i video survejimit është i instaluar në një banesë/objekt në pronësi private për qëllime sigurie, a shkelet privatësia ime? Nëse këndi i shikimit dhe pamjet e siguruar nga sistemi CCTV i referohen ambienteve private, kjo nuk konsiderohet si shkelje e privatësisë. Nëse i referohen ambienteve publike (trotuare, rrugë, banesat e tjera, etj.) kjo do të konsiderohet tejkallim i qëllimit të përpunimit dhe për pasojë do të kemi shkelje të privatësisë. Survejimi i ambienteve publike është kompetencë vetëm e organeve të rendit (policisë).



ZONË E MBIKËQYRUR ME KAMERA



(EMRI I KONTROLLUESIT)

(NR. I KONTAKTIT)

Të gjithë subjektet e të dhënave personale mund të ushtrojnë të drejtat e tyre sipas ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008: "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".